



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 23 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 2493 prot., datë 07.05.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, përmes të cilës kërkonti të informoheni nëse ka nisur një proces verifikimi për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nëse po mbi çfarë baze dhe në çfarë faze është, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në kushtet kur znj. {...}, ka qenë gjyqtare në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, i është nënshtruar verifikimeve përkatëse në zbatim të detyrimeve që burojnë nga ky ligj. Rezulton se, znj. {...} ka depozituar formularin e vetëdeklarimit më datë 22.04.2016, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më datë 08.04.2024, Partia Demokratike e Shqipërisë me anë të shkresës me nr. 68 prot. Datë 08.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 2091 prot. 11.04.2024, i është drejtuar Këshillit të Lartë me kërkesën me objekt verifikimi i pastërtisë së figurës së gjyqtares së Gjykatës Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. {...}, sipas dispozitave të Ligjit nr. 138/2015.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 138/2015, Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes shkresës me nr. 2091/1 prot., datë 19.04.2024, i ka kërkuar organit kompetent Prokuroria e Përgjithshme verifikimin e të dhënave për znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Më tej pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar me aktin nr. 2091/2 prot., datë 19.04.2024 kërkesa e Prokurorisë së Përgjithshme nr. 183/2 prot., datë 19.04.2024 me objekt

“Kërkesë për verifikim” lidhur me verifikimin e të dhënave të vetdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit nga znj {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në vijim të kësaj kërkesë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. 2091/5 prot., datë 29.04.2024 i ka kthyer përgjigje Prokurorisë së Përgjithshme, duke i vendosur në dispozicion informacion lidhur me verifikimet që janë kryer në kuadër të ligjit nr. 138/2015. Po ashtu, Këshilli i ka vendosur në dispozicion Prokurorisë së Përgjithshme edhe dokumentacionin përkatës të këtyre verifikimeve.

Më datë 07.05.2024, Prokuroria e Përgjithshme përmes shkresës protokolluar me tonën me nr. 20191/6. prot. datë 07.05.2024, i ka kthyer përgjigje Këshillit që nga burime publike mediatike ka indicie apo të dhëna për të kërkuar nga Prokuroria e Përgjithshme verifikimin e thelluar. Në kushtet kur verifikimi i këtyre të dhënave përkon dhe me informacionin e sjellë nga Partia Demokratike, Këshilli pasi mori këtë njoftim paraqiti zyrtarisht pranë organit kompetent, Prokuroria e Përgjithshme, kërkesën për verifikim të thelluar duke qenë se verifikimi lidhet me ngjarje që mund të kenë ndodhur në shtetin grek dhe marrja e të dhënave për ngjarje që mund të kenë ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë realizohet përmes verifikimit të thelluar.

Në vijim të më sipër, në kushtet e ekzistencës së indicieve për verifikim të thelluar në lidhje me ngjarje që pretendohet të kenë ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cila si rrjedhojë nuk mund të verifikohen nga ana e Këshillit , përmes shkresës nr. 2091/ 7, datë 08.05.2024, KLGJ i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, me një kërkesë për verifikim të thelluar, mbi përfundimet e së cilës mbetet në pritje.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!